



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 024 prot.

Ballsh më 22 . 02 . 2023

VENDIM

Nr. 08 Datë 21/02/2023

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTIT : REHABILITIM I RRËSHKITJEVE NË RRUGËN
HEKAL – KLOS – POÇEM**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM. Nr. 53, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatëkeqsive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile”, projektit të hartuar nga ana e Bashkisë Mallakastër “Rehabilitim i rrëshkitjeve në rrugën Hekal – Klos – Poçem”,

VENDOSI

1. Miratimin e projektit “Rehabilitim i rrëshkitjeve në rrugën Hekal – Klos – Poçem” në vlerën totale prej 66 260 508.30 lekë (gjashtëdhjetë e gjashtëmilion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e tetë. Tridhjetë) lekë pa TVSH dhe 79 519 610 (shtatëdhjetë e nëntëmilion e pesëqind e nëntëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë me TVSH.
2. Bashkia Mallakastër do të vazhdoj procedurat për financim sipas përcaktimeve të pikës 7 të VKM. Nr. 53, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatëkeqsive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile”, për shkak se vlera e projektit tejkalon vlerën e parashikuar në buxhetin e vitit 2023 i cili është në masën 19 123 120 (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzetë e tremijë e njëqind e njëzetë) lekë dhe është i pamjaftueshëm për zbatimin e projektit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes

KRYETAR

Fitim Baraj

